



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË**

*Drejtoria e Privatizimit të Ndërmarrjeve dhe Shoqërive të Vogla e të Mesme*

**URDHËR**

Nr. 386 Datë 3 12.2003

**PER**

**ZVOGELIMIN E KAPITALIT THEMELTAR TE SHOQERISE ANONIME  
“HOTEL ARBANA” SH.A. TIRANE**

**Drejtuar: Shoqerise Anonime “Hotel Arbana” Sh.a. Tirane**

Duke marre parasysh kalimin kapital te nderteses Arbana te shoqerise Hotel Arbana sh.a. Tirane tek Ministria e Rendit Publik sipas urdherit te perbashket te Ministrise se Rendit Publik, Ministrise se Rregullimit te Territorit dhe Turizmit dhe Ministrise se Ekonomise,

**KONSTATOVA**

Se ne mbeshtetje te nenit 1 te Ligjit nr.8885, date 22/04/2002 “Per disa ndryshime ne ligjin nr.7926, date 20/04/1995 “Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare, ndryshuar me akte te tjera ligjore”; nenet 128, 164 te Ligjit Nr.7638 date 19/11/1992 “Per shoqerite tregtare”, duhet te zvogelohet kapitali themeltar i shoqerise per vleren e pasurise se “Hotel Arbana” Sh.a. Tirane.

Persa me sipër, ne mbeshtetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutes te Republikes se Shqiperise, me cilesine e zoteruesit te aksioneve te shoqerise,

**URDHEROJ:**

1. Ne aktet e themelimit te Hotel Arbana sh.a. te behen ndryshimet e meposhtme:
  - a. Kapitali themeltar te zvogelohet per kalimin kapital te pasurise se Hotel Arbana tek Ministria e Rendit Publik per vleren 219,394,000 leke, e barabarte me 219,394 aksione me vlere nominale 1,000 leke per aksion.
  - b. Kapitali themeltar i Hotel Arbana sh.a. Tirane te behet 43,106,000 leke i perbere nga 43,106 aksione me vlere nominale 1,000 per aksion.Keto ndryshime te behen ne aktin e themelimit dhe ne statutin e shoqerise.
2. Ngarkohet Drejtoria e Privatizimit te Ndermarrjeve dhe Shoqerive te Vogla e te Mesme per kryerjen e veprimeve perkatese ne perputhje me parashikimet e nenit 33 te Ligjit nr.7667, date 28.01.1993 “Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare.

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.



**R A P O R T**  
**I EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR**  
**PER ZVOGELIMIN E KAPITALIT THEMELTAR TE SHOQERISE**  
**"HOTEL ARBANA" SHA TIRANE**

**MINISTRISE SE EKONOMISE**  
 Drejtorise se Priavtizimit te Ndemarrjeve dhe Shoqerive te Vogla  
 dhe te Mesme

Zoterinj,

Ne zbatim te Urdherit Nr.286 date 22.07.2003 te Ministrit te Ekonomise " Per zvogelimin e kapitalit themeltar te Shoqerise Anonime "Hotel Arbana" SHA Tirane" ndemorem misionin e Ekspertit Kontabel te Autorizuar per verifikimin dhe vertetimin e mases se zvogelimit te kapitalit te shoqerise "Hotel Arbana" SHA

Ndoqem ne proces dhe verifikuam operacionet e kalimit te pasurise dhe dokumentacionin perkates te pergatitur ne zbatim te Urdherit te Perbashket Nr. 4488 prot. te Ministrit te Rregullimit te Teritorit dhe Turizmit, Nr. 5830 prot, te Ministrit te Ekonomise dhe Nr. 1656/1 prot. te Ministrit te Rendit Publik, date 25.07.2003, "Per kalimin kapital te Nderteses "Arbana" te Shoqerise "Hotel Arbana" SHA Tirane tek Ministria e Rendit Publik per Drejtorine e Pergjitheshme te Policise se Shtetit".

Vlefte neto e aktiveve qe kaluan ne forme transferimi kapital nga "Hotel Arbana" SHA ne Ministrine e Rendit Publik eshte 234.106.646 llike dhe konkretisht :

- Trualli .....	6.264.000	leke
- Ndertesa "Arbana" me anekset e saj ..	182.327.434	"
- Makineri dhe paisje.....	26.014.011	".
- Iventar Ekonomik.....	16.783.405	"
- Iventari i imet ....	2.717.796	"

Ne audituam llogarite e Shoqerise, sipas bilancit date 30.09.2003, dhe konkludojme se me kete zvogelim kapitali, te pa motivuar nga humbjet, kreditorët mund te mos e kundërshtojne operacionin sipas nenit 165 te ligjit Nr. Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" pasi shoqeria eshte ne gjendje te shlyeje detyrimet me aktivet qe i mbeten pas kalimit kapital te objekteve sipas Urdherit te lartepemendur.

Meqenese Shoqeria kalon ne likuidim llogarite "Rezerva rivleresimi" per 14.096.808 leke dhe "Rezerva ligjore" prej 615.447 leke mund te mbyllet duke u bashkuar me Kapitalin e Nenshkuar.


Mbi kete baze , kapitali themeltar i Shoqerise "Hotel Arbana" SHA " mund te paksohet per 219.394 mije leke.

Perfundimisht, **Kapitali i nenshkruar i Shoqerise "Hotel Arbana" SHA ne likujdim nga 262.500.000 leke behet 43.106.000 leke, i perbere nga 43.106 aksione , te zoteruara teresisht nga Shteti.**

AHMET STOJNA

Date 15.11.2003

EKSPERT KONTABEL I AUTORIZUAR  
LIÇENCA Nr.54



Ekspert Kontabël i  
Autorizuar  
AHMET STOJNA  
Nr. Liç. 54 TIRANË